

Gjuha e lehtë

# Aplikimi për letërnjoftim dhe pasaportë

## Udhëzime

---



Falenderojmë anëtarët e shoqatës

## **Klubi Dëshira**

### **Grupi Kontrollues:**

Lumnije Demolli

Qëndrim Jashari

Driton Krasniqi

Hasan Krasniqi



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Më shumë informata në:

[www.inclusion-europe.eu/easy-to-read](http://www.inclusion-europe.eu/easy-to-read)

Gjuha e lehtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia intelektuale apo pengesa të tjera për të kuptuar.

**Shënim:** Përmbajta e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Renovabis dhe Caritas Austria.



# Hyrje

Kjo broshurë ju ndihmon të kuptoni hapat se si të aplikoni për letërnjoftim dhe pasaportë.



**Pasaportë  
ose  
Letërnjoftim**

Letërnjoftimi është dokument me informata tona personale si:

- Emri
- Mbiemri
- Vendi i lindjes
- Ditëlindja
- Numri personal



Hapat e aplikimit për letërnjoftim janë ndryshe për personat nga 16 deri në 18 vjeç dhe për personat që kanë më shumë se 18 vjet.


## Hapat e aplikimit për letërnjoftim për personat 16 deri në 18 vjeç:



- Ju duhet të shkoni së bashku me prindin ose kujdestarin në Qendrën Komunale për Pajisje me Dokumente në komunën tuaj.



+



- Ju duhet ta merrni pasaportën me vete.
- Nëse nuk e keni pasaportën atëherë merrni me vete çertifikatën e lindjes së bashku me aplikim.



- Ju duhet ta merrni me vete dëshminë e pagesës të cilën e merrni në sportel pasi ta bëni pagesën.

- Prindi i juaj duhet ta ketë me vete letërnjoftimin ose pasaportën.


### **Hapat e aplikimit për personat që kanë më shumë se 18 vjet:**



- Ju duhet të shkoni në Qendrën Komunal për Pajisje me Dokumente në komunën tuaj.



- Ju duhet të merrni pasaportën me vete.



- Nëse nuk e keni pasaportën merrni me vete çertifikatën e lindjes bashkë me aplikim.



- Ju duhet ta merrni me vete dëshmin e pagesës të cilën e merrni në sportel pasi ta bëni pagesën.





- Nëse po aplikoni për të ndërruar të dhënat ju duhet të merrni me vete letërnjoftimin original dhe çertifikatën e lindjes.



- Nëse po aplikoni për shkak që ju ka humbur letërnjoftimi ju duhet të merrni raportin policor nga policia në komunën tuaj.



- Nëse po aplikoni për shkak që është prishur letërnjoftimi juaj ju duhet ta merrni me vete një kopje të letërnjoftimit të prishur.

## Aplikimi për letërnjoftim



## Çmimi dhe koha për të marrë letërnjoftimin

Janë dy mënyra që të aplikoni për letërnjoftim. Mënyra e ngadaltë dhe e shpejtuar.



Mënyra e ngadaltë është e rregullt dhe kushton 10 euro.



Mënyra e ngadaltë e aplikimit merr kohë deri në 15 ditë për të marrë letërnjoftimin.



Mënyra e dytë është e shpejtë dhe kushton 60 euro.



Mënyra e shpejtë e aplikimit merr kohë deri në 72 orë për të marrë letërnjoftimin.

## Aplikimi për pasaportë



Pasaporta ka të njëjtat informata. Pasaportën e përdorim për të udhëtuar jashtë shtetit.


## Hapat e aplikimit për pasaportë për personat 16 deri në 18 vjeç:



- Nëse jeni prej 16-18 vjeç ju duhet të merrni prindërit ose kujdestarin me vete.
- Ju duhet të shkoni në Qendrën për Pajisje me Dokumente në komunën tuaj.



- Ju duhet të keni letërnjoftimin tuaj me vete.



- Prindërit duhet të kenë dokument me vete që thotë se janë prindërit tuaj.

## Hapat e aplikimit për personat mbi 18 vjet



- Ju duhet të shkoni në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Komunën tuaj.
- Ju duhet të merrni letërnjoftimin tuaj me vete.
- Ju duhet të merrni pasaportën e fundit nëse e keni.

## Aplikimi për pasaportë



## Çmimi dhe koha për të marrë pasaportën

Janë dy mënyra që të aplikoni për pasaportë. Mënyra e ngadaltë dhe e shpejtuar.

Mënyra e ngadaltë është e rregullt dhe kushton 30 euro.

Mënyra e ngadaltë e aplikimit merr kohë deri në 15 ditë për të marrë pasaportën.

Mënyra e dytë është e shpejtë dhe kushton 80 euro.

Mënyra e shpejtë e aplimit merr kohë deri në 72 orë për të marrë pasaportën.



## Pasaportë ose Letërnjoftim



Në rast se nuk i gëzoni këto të drejta gjatë aplikimit për pasaport dhe letërnjoftim atëherë mund të ankoheni.



Ankesën mund ta bëni tek avokati i popullit:



Telefoni: 038223782

Email: [info.oik@oik-rks.org](mailto:info.oik@oik-rks.org)

Adresa: Rruga Migjeni, Prishtinë



Për të përmirësuar punën, ju lutemi vlerësoni tekstin.  
Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose  
nëpërmjet lidhjes:

<https://forms.gle/qNbXxNhhXtiRCxh9>



**CARITAS  
KOSOVA**

**Përgatitur: Caritas Kosova**

**[www.caritaskosova.org](http://www.caritaskosova.org) / 383 (0) 290 328 110**

**[info@caritaskosova.org](mailto:info@caritaskosova.org)**

**Adresa: Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike  
70000 Ferizaj, Kosovë**